

Kontaktet për Ndhimë:

- **Zyra e Shërbimit Social Shtetëror**
Rruga e Durresit, Nr. 83 - Tiranë
- **Policia e Shtetit**
Bulevardi Bajram Curri, Tiranë
- **Agjencia për Mbrojtjen e Fëmijëve**
Rruga e Kavajes, 1001 Tiranë
- **Klinika ligjore për te mitur**
Bulevardi "Bajram Curri", Pallatet Agimi, Shk.18,
Ap.322, Tiranë
- **Komiteti antitrafik**
Ministria e Punëve të Brendshme - Sheshi
'Skënderbej', nr.3 - Tiranë
- **Alo 116**
Rruga Perlat Rexhepi, - Tiranë

Në 1989, qeveritë në mbarë botën u premtuan të gjithë fëmijëve të njëjtat të drejta duke miratuar Konventën e OKB mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF). Këto të drejta bazohen në nevojat e fëmijëve për të mbijetuar, për t'u rritur, për të marrë pjesë dhe për të përmbyshur potencialin e tyre. Ato zbatohen në mënyrë të barabartë për çdo fëmijë, pavarësisht se cili/a është ose nga është.

TË DREJTAT E FËMIJËVE

0-18 vjeç: Ju keni të gjitha të drejtat!

- Mbrojtja e jetës dhe mirëqenies fizike, mendore, shpirtërore, morale dhe sociale.
- Respekti për nevojat tuaja themelore: të jeni ushqyer siç duhet, të veshur, të keni një banesë dhe të kujdeseni për veten.
- Një identitet: një emër, një mbiemër dhe një kombësi
- Të trajtoheni si fëmijët e tjerë pavarësisht nëse jeni mashkull, femër pavarësisht origjinës tuaj, mendimeve tuaja, besimit tuaj apo besimit të prindërve tuaj.
- Të kesh prindërit dhe të jetosh në familje.
- Arsimit më të mirë të mundshëm
- Mbrojtja kundër të gjitha formave të shfrytëzimit, abuzimit seksual dhe dhunës fizike ose mendore.
- Pushimi, lojrat, aktivitetet kulturore dhe artistike të përshtatshme për moshën.
- Kushtet e veçanta që sigurojnë dinjitetin dhe autonominë tuaj kur jeni i sëmurë, ose në qoftë se keni një aftësi të kufizuar fizike apo mendore.
- Mbrojtja e jetës tuaj private duke përfshirë këtu edhe rrjetet sociale.
- Të shprehni, të merni pjesë në vendimet që ndikojnë të ju apo në jetën tuaj sociale.

Projekti "Përfshirja e Shoqërisë Civile në Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve" financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Save the Children në partneritet me Terre des Hommes në Shqipëri.

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD)

Bulevardi "Gjergj Fishta"

Kompleksi "Tirana 2000", Kulla 4, Tiranë

Tel: (04)225-14-75; email: info@acpd.org.al



QENDRA SHQIPTARE PËR POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT



This project is funded
by the European Union



Çfarë është trafikimi i fëmijëve...

Trafikimi i fëmijëve është: Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja, shitja ose pritja e të miturve përmes forcës ose jo, mashtrimit, përfitimit nga të qenit i pambrojtur ose i varfër me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit.

Pse fëmijët bëhen pre e trafikimit...

- ▶ **VARFERIA:** Shumë rekrutues shkojnë drejt lagjeve të varfëra, zonave rurale ku ka pllakosur varfëria dhe ku ka mundësi të kufizuara punësimi.
- ▶ **DISKRIMINIMI GJINOR:** Në shumë shoqëri ka vlerësim të ulët për gruan në raport me burrat, ato trajtohen shpesh si pronë dhe përjetojnë dhunë duke ju mohuar kështu të drejtat e tyre.
- ▶ **KULTURA:** Në disa kultura është traditë tashmë martesë e fëmijëve apo dërgimi i tyre larg familjes për mundësi më të mira jetese.
- ▶ **GLOBALIZIMI:** Eshtë rritur lëvizja e njerëzve dhe mallrave si rezultat i globalizimit gjë që ua ka bërë shumë më të lehtë trafikantëve transportimin e fëmijëve përtej kufijve.
- ▶ **MOSFUNKSIONIMI I FAMILJES DHE BRAKTISJA E FEMIJEVE:** Kur familjet mbesin të pastrehë, janë të detyruar të lëvizin nga vendi në vend, apo prindi sëmurët, vdes ose braktis familjen, apo prindërit kanë mundësi të kufizuara për t'u kujdesur apo mbrojtur fëmijët e tyre.

Si mund të dyshosh që një fëmijë mund të jetë viktimë e trafikimit...

- ▶ Kur kërkon ndihmë se është keqpërdorur, abuzuar, kërcënuar, shfrytëzuar;
- ▶ Kur ka shenja në trup, (mavijosje p.sh.), që tregojnë dhunë fizike ose seksuale ndaj tij/saj;
- ▶ Kur lyp e ka gjithmonë një të rritur pranë që e kontrollon;
- ▶ Kur shet ose punon për orë të gjata në kushte të vështira;
- ▶ Kur nuk ka kontakte me familjen dhe nuk ka person me lidhje gjaku që kujdeset për të;
- ▶ Kur është sjellë në qytet apo në fshat nga një person i rritur apo më i rritur me të cilin nuk ka lidhje familjare;
- ▶ Kur është i/e paregjistruar e qëndron me persona të rritur me të cilët nuk ka lidhje familjare;
- ▶ Kur është në shoqërinë e personave që shfrytëzojnë apo trafikojnë të miturit;
- ▶ Kur nuk ka një vendbanim të qëndrueshëm;
- ▶ Kur fle në rrugë.

Trafikimi është veprë penale dhe Kodi Penal e dënon trafikimin e fëmijëve me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Të drejtat e fëmijëve viktimat të trafikimit...

- ▶ Fëmijëve të pashoqëruar u caktohet një kujdestar ligjor për t'i përfaqësuar ata dhe për të vepruar në interesin e tyre më të mirë;
- ▶ Merren masa për të përcaktuar identitetin dhe nënshtetësinë e fëmijëve dhe, në rast se është në interesin më të mirë për fëmijët, për të gjetur/lokalizuar familjet e tyre;
- ▶ Kur moshë e viktimës nuk është e sigurt, por kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se viktimat është nën 18 vjeç, viktimat supozohet të jetë fëmijë dhe përfiton masa të posaçme mbrojtjeje në pritje të verifikimit të moshës;
- ▶ Fëmijët kanë të drejtë të përfitojnë masa arsimi dhe ndihme të cilat marrin parasysh nevojat e tyre;
- ▶ Përpara riadhesimit, që duhet të bëhet vetëm në rast se ai është në interesin më të mirë të fëmijës, kryhet një vlerësim rreziku dhe sigurie;
- ▶ Fëmijët përfitojnë nga masa të posaçme mbrojtjeje gjatë hetimit dhe proceseve gjyqësore.